



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 802/3 Prot.

Vlorë më, 14 . 05. 2021

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 11. 05. 2021**

**PËR  
SHTYRJEN E AFATIT PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR  
STUDENTËT QË NDJEKIN STUDIMET NË PROGRAMIN E INTEGRUAR NË  
DREJTËSI NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Në mbështetje të nenit 49, pika 1, gërma ë, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe propozimit të Fakultetit të Shkencave Humane shkresa nr. 470 prot, datë 18. 03. 2021, miratuar dhe me vendim Senati Akademik nr. 9, datë 19. 03. 2021, në mbledhjen e datës 11. 05. 2021 Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë shtyrjen e afatit të pagesës së tarifës së shkollimit, për studentët që ndjekin vitin e parë të studimit që ndjekin vitin akademik 2020- 2021, në programin e Integruar në Drejtësi, deri në datën 11. 06. 2021.
2. Për vitet pasardhëse për studentët që ndjekin programin e studimit të Integruar në Drejtësi afati i pagesës do të kryhet në dy këste:
  - Kësti i parë të paguhet brenda 60 ditëve nga data e fillimit të vitit të ri akademik.
  - Kësti i dytë të paguhet para fillimit të sezonit të provimeve të pranverës.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
Dr. ERVIS MOÇKA**

